

Bashkimi familjar

Anëtarët e familjes të personave, të cilët jetojnë në Zvicër, sipas rrethanave mund të vendosen në Zvicër. Kur të afërmit apo të njofshmit dëshirojnë ta vizitojnë Zvicrën, sipas vendit të origjinës, duhet të aplikojnë për një vizë vizite.

Bashkimi familjar

Parimisht ekziston mundësia, që edhe antarët e familjes (të afërmit e drejtpërdrejt apo partneri bashkëshortor) i personit që jeton këtu, të vije në Zvicër (Bashkimi familjar, Familiennachzug). Për cilët antarë të familjes mund të aplikohet, varet prej përkatsisë shtetërore dhe leje qëndrimit të aplikuesit të kërkesës. Edhe personat me lejeqëndrim të përkohshëm (letërnjoftim F), sipas rrethanave mund ta tërheqin familjen e tyre. Enti për Migrim dhe Integrim i kantonit (Amt für Migration und Integration) vendos për kërkesën dhe jep informata për dokumentet e nevojshme dhe ecurinë e saktë të procedurës. Kujdes: Bashkimi familjar duhet të procedohet mbrenda një afati të caktuar. Te fëmijët ky është më i shkurtër se te personat e rritur (p.sh. partneri bashkëshortor).

Përgatitja për martesë

Personi që jeton në Zvicër dhe dëshiron të martohet me një partner/e nga jashtë vendit, mund të aplikojë për lejehyrje për përgatitjen e martesës. Kjo leje i mundëson partneres ose partnerit të hyjë në Zvicër para martesës dhe të martohet këtu. Enti për Migrim dhe Integrim i Kantonit (Amt für Migration und Integration) vendos për kërkesën dhe jep informata rreth dokumenteve të nevojshme dhe procesit të saktë të procedurës.

Viza hyrëse

Për banorët e shumë vendeve, nuk është e lehtë të marrin një vizë hyrëse për në Zvicër, për të vizituar për shembull familjarët e tyre këtu. Mund të kërkohet një letër ftese dhe / ose një garanci financiare (deklaratë përgjegjësie, Verpflichtungserklärung) nga personat që jetojnë këtu. Për kërkesën vendos dhe jep informata rreth dokumenteve të nevojshme dhe procedurës së saktë, përfaqësia zvicerane jashtë vendit. Informatat mund të merren gjithashtu edhe në Entin për Migrim dhe Integrim të kantonit (Amt für Migration und Integration).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

dev.hallo-aargau.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/terheqja-e-familjes